



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosova



Komuna e Drenasit/Gllogocit
Opština Gllogovac
Municipality of Drenas

Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore
Nr. 01- 111/01- 40461, Datë: 23.08.2021

Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore për zbatim të paragrafit 12 të nenit 34 të Ligjit për Zyrtarët Publik dhe nenit 18 të Rregullorës (qrk) nr.16/2020 pranimin dhe karrierën në shërbimin civil të Republikës së Kosovës, bën këtë:

SHPLLJE PUBLIKE

për një (1) ekspert të jashtëm në fushën e përzgjedhjes/vlerësimit të burimeve njerëzore nga organizata të specializuar apo universitetet

Detjrat dhe përgjegjësitë

Eksperti i jashtëm do të jetë anëtar i Komisionit të pranimin dhe do të kryejë detyrat e tij, ashtu siç janë të përcaktuar në Rregullorën (qrk) nr. 16/2020 për pranimin dhe karrierën në shërbimin civil të Republikës së Kosovës.

Kriteret e kërkuara

Aplikantët duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- Të kenë diploma universitare të paktën 240 kredi, për edukimin e marrë jashtë vendit duhet të nostrifikimi i diplomës;
- Të kenë përvojë pune të paktën katër (4) vite në pozita të nivelit drejtues;
- Të mos kenë qenë anëtarë të organeve drejtuese të ndonjë partie politike pesë (5) vitet e fundit;
- Të kenë integritet moral dhe profesional;
- Të mos kenë qenë të dënuar penalisht për kryerjen e një veprë penale;
- Të mos jetë i punësuar në shërbimin civil, të mos jetë i larguar nga shërbimi civil si rrjedhojë e masave disiplinore dhe të mos kenë mas disiplinore në fuqi.

Pagesa: Pagesa është fikse 250 Euro e cila iu paguhet ekspertit për çdo procedurë të konkurimit në të cilën është i angazhuar.

Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit

Së bashku me aplikacionin kandidatët duhet të dorëzojnë edhe dokumentacionin si më poshtë:

1. CV
2. Fotokopje të Diplomës të noterizuar;

3. Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
4. Dëshminë për përvojën e punës;
5. Dëshminë se nuk është i dënuar penalisht për kryerjen e një vepre penale;
6. Deklaratë se nuk ka qenë anëtarë i organeve drejtuese të ndonjë partie politike të paktën pesë (5) vitet e fundit;
7. Deklaratë se nuk është i punësuar në shërbimin civil të mos jetë i larguar nga shërbimi civil si rrjedhojë e masave disiplinore dhe të mos kenë masa disiplinore në fuqi.

Formularët e aplikimit merren në Qendrën për shërbim me qytetar dhe në web-faqen komunale dhe dorëzohen në Qendrën për shërbim me qytetar, kati i parë, në objektin e Komunës së Drenasit.

Afati për pranimin e aplikacioneve është 8 ditë duke filluar prej datës 23.08.2021 deri me 30.08.2021

Pas vlerësimit të kandidatëve Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore publikon listën e kandidatit fitues në web-faqën komunale.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.

Të gjitha dokumentet e dorëzuara siç kërkohen shpallja e konkurimit, kandidati përmes aplikacionit, vetdeklaron se janë të vërteta dhe mban përgjegjësi për vërtetësinë e tyre. Deklarimi i rrejshëm paraqet shkak për përjashtimin nga procedura. Për çdo informacion kandidatët mund të kontaktojnë Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore.



Zyra e Personelit

Blatunisha Shabani, Zv.Udhëheqësit P.